

**RELACION
PËR
PROJEKT-VENDIMIN
“MBI PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE KËRKESAVE PËR
INFRASTRUKTURËN E BRENDSHME TË GODINAVE DHE TË
ADMINISTRIMIT TË PIKËS SË AKSESIT NË GODINË PËR RRJETET
E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projekt-vendimi “Mbi përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë për rrjetet e komunikimeve elektronike” është propozim i Ministrit për Infrastrukturen dhe Energjinë, në përputhje me pikën 4 të nenit 20, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”. Ky projekt-vendim përcakton rregullat dhe kërkesat për infrastrukturën e brendshme fizike të godinave të gatshme për komunikime elektronike me shpejtësi të lartë deri në pikën fundore dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projekt-vendimi është parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2018 dhe vjen si nevojë e plotësisimit të kuadrit nënligjor, në zbatim të ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, në pikën 4, të nenit 20 ka parashikuar në vija të përgjithshme, rregullat dhe kërkesat për infrastrukturën e brendshme fizike të godinave për komunikime elektronike me shpejtësi të lartë deri në pikën fundore dhe administrimin e pikës së aksesit në godinë për rrjetet e komunikimeve elektronike. Këto rregulla do të zbatohen për çdo godinë të re si dhe, gradualisht për ndërtesat ekzistuese, kur ato janë objekt i punimeve të

Relacion shpjegues për Projekt-vendimin “Mbi përcaktimin e rregullave dhe kërkesave për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë për rrjetet e komunikimeve elektronike”.

rikonstruksionit, riparimeve apo rindërtimit dhe punimeve rinovuese të mëdha. Gjithashtu projektvendimi adreson një problematikë lidhur me të drejtën e çdo përdoruesi fundor për të përzgjedhur ofruesin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projekt-vendimi është hartuar në mbështetje të nenin 100 të Kushtetutës, pika 2 dhe të nenin 20, pika 4 e Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projekt-vendimi nuk transpozon ndonjë akt të veçantë të acquis të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është i hartuar në 10 pika, në të cilat përcaktohen ndër të tjera:

- rregullat dhe kërkesat për infrastrukturën e brendshme fizike të gatshme për komunikime me shpejtësi të lartë deri në pikën fundore, për instalimin e rrjetit kabllor (bakër, fibër optike, kabëll koaksial etj.), i cili mundëson shpërndarjen e shërbimeve broadband me shpejtësi mbi 30 Mbps;
- rregullat që duhet të zbatojnë ofruesit e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike me qëllim ndërtimin e rrjetit të tyre deri në pikën fundore;
- administrimi i pikës së aksesit në godinë, i cili do të kryhet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit etj.

Përsa i përket specifikimeve teknike për dimensionin e tubacioneve, rrjeteve kablore dhe kasetat e pikës së aksesit në godinë, ato do të miratohen me rregullore nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohet për zbatimin e këtij projekt-vendimi janë autoritetet planifikuese, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe ofruesit e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projekt-vendimi është hartuar nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekt-vendimi nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI